



GEMEINSAMES  
NEUENTDECKEN

TË RIZBULOJMË  
TË PËRBASHKËTAT

AUSTRIA - ALBANIA CULTURAL YEAR 2018

# MUSIC-FILM TIRANA FESTIVAL



**JAVA E FILMIT DHE MUZIKËS  
AUSTRIAKE DHE SHQIPTARE NË TIRANË**

**13-20 SHTATOR**

në Pazarin e Ri

**Muzikë - Filma - Gastronomi**



Dr. Johann Sattler,  
Ambasador i Republikës së Austrisë në Shqipëri

Erion Veliaj  
Kryetar i Bashkisë së Tiranës

Të dashur qytetarë dhe miq të Tiranës, të dashur "tironisë"! Në këtë vit të veçantë për kulturën austriake dhe shqiptare, që bashkon dy vendet tona nën moton "Të (ri)zbulojmë të përbashkëtat", kemi kënaqësinë t'ju urojmë mirëseardhjen në një tjetër aktivitet të rëndësishëm, që do të pasurojë netët e këtij mes shtatori në Pazarin e Ri të Tiranës duke shpresuar që "Music-Film Festival Tirana", që zhvillohet për herë të parë, të shndërrohet në një pjesë të rëndësishme të jetës kulturore të Tiranës. Frymëzimi ynë ka qenë festivali i mirënjohur "Vienna Film Festival on Rathausplatz", i cili për më shumë se 25 vite fton në Vjenë çdo verë qindra mijëra njerëz të shikojnë në një ekran të madh filmat më të mirë muzikorë duke shijuar produkte të shijshme kulinarie. Duke dëshiruar të sjellim ekperiencën Vjeneze në zemrën e Tiranës në këtë edicion të parë kemi përzgjedhur dhe bërë bashkë një grup filmash muzikorë dhe koncertesh austriake dhe shqiptare, nga klasikët tek ato modernët, nga Orkestra Filarmonike e Vjenës tek Festivalet Folklorike të Gjirokastrës, nga legjendari Parov Stelar te famëkeqi Festivali i 11- të , nga "Zare Trendafil" e Tefta Tashkos te filmi „Koncert në vitin 1936“ te kënga famëmadhe në Shqipëri "Jeanny" e superstarit vjenez Falco. Ju urojmë të gjithëve një festival të këndshëm dhe netë shtatori frymëzuese në Pazarin e Ri. Shijojeni!

Johann Sattler dhe Erion Veliaj





GEMEINSAMES  
NEUENTDECKEN

TË RIZBULOJMË  
TË PËRBASHKËTAT



AUSTRIA - ALBANIA CULTURAL YEAR 2018

**MUSIC-FILM  
TIRANA FESTIVAL**

**13 deri në 20 Shtator 2018  
në Pazarin e Ri**

Një ndërthurje midis muzikës, filmit dhe gastronomisë që do ju mirëpresë dhe zbavisë të gjithë, çdo mbasdite nga 13 deri në 20 shtator 2018 në Pazarin e Ri.

*Ky festival u mundesua nga:*



*Një falenderim i veçantë:*

Alba Frangaj  
Ardit Dakshi  
Arenc Haxhillari  
Claudia Kruzik  
Dori Xhaxhiu  
Edit Pula  
Elisabeth-Maria Dirnberger  
Eljana Mankollari  
Edvin Kazimati  
Eptan Lohja

Erand Meca  
Erinda Hajrullai  
Eriona Vyshka  
Erjona Hanku  
Fatjola Hoxha  
Florian Canga  
Genc Permeti  
Gentian Lula  
Heribert Haller

Ilir Butka  
Iris Elezi  
Lediona Bariu  
Miranda Përgega  
Rovena Hasa  
Ruth Pflutschinger  
Sonila Haxhiu  
Urita Dokle  
Orest Qafoku  
Wolfgang Mitter

*Festivali u organizua nga:*



**EDS**  
foundation





## LOUIE AUSTEN ELECTRONIC SET

Me zërin e tij të butë dhe enigmatik, Louie Austen ka arritur t'i ofrojë botës disa prej performancave më të shkëlqyera të muzikës elektronike. "Arti duhet të jetë një çështje jete a vdekjeje, përndryshe nuk është art," është një nga motot që e ka udhëhequr artistin austriak të rrymës Jazz që nga vitet 60 e deri më sot. Me stilin e tij të veçantë, Austen synon të ndërtojë ura artistike mes të vjetrës dhe të resë, të shkuarës dhe të tashmes. Që nga viti 2007, ky muzikant i talentuar themeloi shtëpinë e tij muzikore LA Music Louie Austen Music, e cila i dha jetë shumë tingujve magjikë të muzikës elektronike në të cilat Austen interpretoi dhe performoi me pasion.



Warm-up Naam Van  
DJ set



## TINGUJT E ZJARRTË

Dokumentari sjell momente nga krijimi i grupit “Tingulli i Zjarrtë”, drejtuar nga Elton Deda i cili mori famë me këngën pjesëmarrëse në Festivalin e 29 të Këngës në RTSH, “Jemi emri i vetë jetës”. Në këtë film dokumentar trajtohet jeta studentore e të rinjve të Liceut Artistik “Jordan Misja” gjatë vitit 1990, dhe vihet re dëshira e madhe dhe përpjekjet e të rinjve shqiptarë, për të përqaftuar trendet muzikore botërore të viteve 80’-90’.

Regjia: Ardian Murraj, Skenari: Ardian Murraj, Muzika: Mira Mecule, Producent: Shqipëria e Re, Viti: 1991, 27’





## SUMMER NIGHT'S CONCERT

Që prej vitit 2004, Koncerti i Mbrëmjes së Verës, nga Orkestra Filarmonike e Vjenës që zhvillohet në Schönbrunn përveç Koncertit tradicional të Vitit të Ri është cilësuar si përshëndetja më e rëndësishme muzikore e Austrisë për gjithë botën. Në mes të parkut unik të Pallatit të Schönbrunn, Filarmonia e Vjenës fton çdo vit banorët e qytetit dhe të ftuar nga gjithë bota në një gosti muzikore të një niveli të lartë. Në vitin 2017 kjo gosti ishte nën dirigjimin e Christoph Eschenbach, fitues i çmimit Grammy për "Best Classical Compendium" dhe drejtues i orkestrave simfonike me prestigjoze të muzikë klasike. Pjesë nga Dvorak, Smetana, Stravinsky, Rachmaninoff, Tchaikovsky, Dirigjent: Christoph Eschenbach, Solist: Renée Flemming, Orkestra: Filarmonia e Vjenës, Viti: 2017, 94'





## AIDA NË SALZBURG FESTIVAL

Me këtë produksion të shkëlqyer të shfaqur në Festivalin e Salzburgut, Anna Netrebko vlerësohet nga kritika si një nga performueset më të mira të rolit të Aida-s kompozuar nga Giuseppe Verdi. E shoqëruar nga Francesco Meli si Radamès dhe Ekaterina Semenchuk si rivalja e saj Amneris, nën dejtimin e orkestres nga eksperti i padiskutueshem i muzikes hyjnore të Verdit, Riccardo Muti. Aida është sjellë nga regjizorja iraniane, fituese e disa çmimeve ndërkombetare, fotografe dhe video artiste Shirin Neshat, e njohur për analizat e saj kritike të roleve gjinore dhe fundamentalizmit fetar. Një skenë dhe kast artistësh të papërsëritshëm që kanë sjellë një performancë për të mos u humbur.

Aida nga Giuseppe Verdi, Dirigjenti: Riccardo Muti, Solistët: Anna Netrebko, Francesco Meli, Roberto Tagliavini, Ekaterina Semenchuk, Dmitry Belosselskiy, Orkestra e Filarmonisë së Vjenës, Viti: 2017, 160'





## PRANVERË NË GJIROKASTËR

Film muzikor. Dy të rinj që e kanë njohur njëri tjetrin gjatë një aksioni rinie, po martohen. Rugës për në shtëpinë e nuses, dhëndri dhe krushqit udhëtojnë nëpër qytete ku ndihen përgatitjet për festivalin folklorik të Gjirokastrës. Pas ceremonisë së martesës, nusja merr pjesë në festival.

Regjia: Muharrem Fejzo, Skenari: Kico Blushi, Muzika: folk, Producent: Shqipëria e Re, Viti: 1978, Kohëzgjatja: 86'





## HOT CLUB TIRANA

Grupi Hot Club Tirana është krijuar në vitin 2015. Hot Club Tirana është i njohur për performancat e tij të vecanta në rrymat muzikore si, gypsy jazz, swing dhe klezmer.

Grupi është i përbërë nga Valin Qerimaj – Violin, Flavio Lito dhe Arbër Çerri - Guitar, Regis Laja - Piano & Trumpet, Ergys Halili-Drums dhe Gigliola Haveriku – Vocal.





Nga Festalet e fëmijëve në vite



**Inva  
Mula**


**Irma Libohova, Pirro Petro**



**Artid Gjebrea**



Kolazh me këngët më të bukura nga Festalet e fëmijëve ndër vite. Me këtë trashëgimi risjellim edhe artistët më të mirë të skenës sonë, të cilët e kanë filluar karrierën kur ishin të vegjël. Në këto festivale kanë kënduar sopranoja e madhe Inva Mula, këngëtarja Irma Libohova, Artit Gjebrea, Kastriot Tusha, Frederik Ndoci, Zana Cela, David Tukiçi e shumë e shumë të tjerë. Sot, ata interpretojnë në skena prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare.



**Zana Çela**



**David Tukiçi**



## ANNA BOLENA

Anna Bolena është një vepër tragjike me dy akte e kompozuar nga Gaetano Donizetti në vitin 1830. Ishte Felice Romani ai që shkroi libretën italiane dhe përshkroi jetën e Anne Boleyn, gruas së dytë të mbretit anglez Henri VIII. Opera u shfaq për herë të parë në Milano, në Teatrin Carcano, më 26 dhjetor 1830 dhe pati një sukses të jashtëzakonshëm. Pas kësaj arritjeje kompozitori Gaetano Donizetti filloi të përmendej si një nga tre emrat më të suksesshëm në botën e operas italiane, përkrah me Bellini dhe Rossini.

Kompozitor Gaetano Donizetti, Dirigjenti: Evelino Pidò, Solistët: Anna Netrebko, Elina Garanča, Elisabeth Kulman, Francesco Meli, Ildebrando D'Arcangelo, Orkestra: Opera e Shtetit e Vjenës, Viti: 2011, 193'





## NË FESTIVALIN E 11 TË KËNGËS

Ky dokumentar i kushtohet Festivalit të 11-të të këngës në RTSH, i cili u zhvillua në Dhjetor të vitit 1972 në Tiranë. Ky festival u dënua dhe ndalua nga sistemi komunist sepse përhapte kulturën dekadente borgjeze. Megjithëse këngët e tij i mbijetuan trysnisë komuniste, ai mbeti në histori si festivali famëkeq për të cilin u dënuan ose u përjashtuan shumë artistë.

Regjia: Donika Muci, Operatorë: Operator: Ilia Terpini, Saim Kokona, Bardhyl Martiniani, Prodhuar nga Shqipëria e Re, Viti: 1973, 11'.





## PAROV STELAR NË BALOISE SESSION

Parov Stelar është një DJ austriak dhe producent, i cili luan një përzierje të xhazit, house dhe downbeat. Ai është konsideruar si një nga pionierët më të rëndësishëm të electro-swing, duke punuar me yje të tillë si Lana del Rey, Bryan Ferry dhe Lady Gaga etj. Hiti i tij më e suksesshme deri më sot, " Booty Swing ", arriti klasifikimet më të larta në iTunes në SHBA dhe Kanada. Regjistrimi është nga koncerti i Parov Stellar dhe orkestrës së tij në festivalin muzikor Baloise Session i cili mbahet çdo vit në Bazel të Zvicrës.





## VALLËZIMI I SHQIPEVE

Një film dokumentar që pasqyron bukuritë e natyrës së Shqipërisë xhiruar në vitin 1960. Panorama dhe pamje madhështore të liqeneve, parqeve, luleve, bregdetit, luginave dhe maleve të vendit tonë, ndërthurur me tingujt e këngëve dhe valleve popullore si: Vallja e Shpatave, Vallja Dropullite, Vallja e Zerqanit, Vallja e Tropojes, Vallja e Shqipeve.

Regjia: Endri Keko, Skenari: Kin Dushi Muzika: Cesk Zadeja, Prodhuar nga Shqipëria e Re, Viti: 1960, 20'





## MOZART - REQUIEM IN D MINOR, K. 626

Requiem në D minor, K. 626, është vepra e fundit e kompozuar nga Wolfgang Amadeus Mozart. Mozart punoi pjesë të Requiem në Vjenë në fund të 1791, por nuk e përfundoi dot para vdekjes së tij më 5 dhjetor të të njëjtit vit. Kjo pjesë u plotësua në vitin 1792 nga Franz Xaver Süssmayr dhe iu dorëzua Count Franz von Walsegg, i cili porosi Requiem-in për të përkujtuar përvjetorin e vdekjes së gruas së tij. Süssmayr e ndan Requiem në 14 seksione: Introitus, Kyrie, Sequentia, Offertorium, Sanctus, Benedictus, Agnus Dei dhe Communio.

Kori: Arnold Schönberg, Dirigjent: Harnoncourt Nikolaus, Solist: Soprano – Schäfer Christine, Alto – Fink Bernarda, Bass – Finley Gerald, Tenor – Gura Werner





## HONEYMOONS

Honeymoons është një film serbo-shqiptar i zhanrit dramë me regjizor Goran Paskaljevic. Filmi trajton dramën e emigrimit të dy cifteve të rinjsh të cilët lënë vendet e tyre në kërkim të një jete më të mirë. Majlinda dhe Niku largohen nga Shqipëria me anije drejt Italisë për të jetuar dashurinë e tyre të ndaluar. Ndërkohë, Vera dhe Marko i thonë "lamtumirë" Serbisë duke u larguar me tren drejt Austrisë.

Regjia: Goran Paskaljevic, Skenari: Goran Paskaljevic, Genc Permeti, Muzika: Rade Krstic, Producent: Ilir Butka, Nikolaj Divanovic, Dritan Huqi, Goran Paskaljević, Viti: 2009, 95'





## FALCO – HELDEN VON HEUTE

Austria, vendi i Mozartit, Beethovenit, Schubertit, Lisztit dhe Strauss nuk ka pasur asnjëherë një ndikim më të madh në skenën botërore të pop-it se sa me Falco. Dy hitet e tij të viteve '80 me famë botërore janë "Der Kommissar" dhe "Rock Me Amadeus". Në materialin video-muzikor "Falco – Helden von heute" (Heronjtë e sotëm) fokusi është Falco. Autori dhe regjizori Rudi Dolezal tregon ngritjen e një ylli duke përdorur video muzikore nga albumi "Junge Roemer".

Falco (Johann Hölzel) 19 Shkurt 1957 - 6 Shkurt 1998 këngëtar, kompozitor dhe rapper Austriak.



18 Shtator



## KËNGË E VALLE NGA GURRA POPULLORE

Film mbi Festivalin folklorik kombëtar të Gjirokastrës të vitit 1968. Në datat 8-16 tetor 1968, në kalanë e gurtë të qytetit të Gjirokastrës hapi siparin dhe u zhvillua edicioni i parë i Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës. Ky Festival cilësohej si veprimtaria më e rëndësishme në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale në atë periudhë. Në të merrnin pjesë grupe artistike nga e gjithë Shqipëria.

Regjia: Gëzim Erebara, Skenari: Gëzim Erebara, Bashkëpunëtorë: Ilia Terpini, Donika Muçi, Asim Raxhimi, Producent: Shqipëria e Re, Viti: 1969, 69'





## VIENNAS BOYS CHOIR SILK ROAD SONGS ALONG THE ROAD AND THE TIME

Regjisori i mirënjohur ndërkombëtar Curt Faudon përshkruan veprimtarinë e Korit të Vjenës, korit më të famshëm të djemve në botë. Duke përdorur një kombinim me elemente të dokumentarit dhe kinematografisë, ky film të bën të përjetosh një udhëtim në kohë, në shumë vende nëpërmjet Rrugës së Mëndafshit, përmes syve të djemve të Korit të Vjenës. Një eksperiencë prekëse me performanca muzikore të jashtëzakonshme, gjithë mister dhe me një të ftuar special: një gamile që flet.

Regjia: Curt Faudon, Autori: Curt Faudon, Tina Breckwoldt, 2008





## KARNAVALET

Ekranizim i komedisë "Karnalet e Korçës" nga Spiro Çomora. Në ditët e karnavaleve, shërbyesja Nasta dhe Loni venë në lojë tregtarin Nikollaq Jorganxhi dhe të shoqen Olimbinë. Ky është momenti kur ata mund të shprehin mendimin e tyre në lidhje me individët e zbrazët, materialistë, injorantë dhe servilë. Filmi është komedia e parë muzikore shqiptare.

Regjia: Ismail Zhabjaku, Skenari: Gjergj Zheji, Ismail Zhabjaku, Muzika: Avni Mula, Prodhuar nga Shqipëria e Re, Viti: 1980, 81'





## ATTWENGER

Attwenger është një dyshë e famshme Austriake që u formua në Linz në vitin 1990. Grupi përbëhet nga bateristi Markus Binder dhe Hans Peter Falkner në fizarmonikë. Binder dhe Falkner janë dy këngëtarë të cilët derdhin talentin e tyre në një zhanër të kombinuar mes folkut të Austrisë dhe hip-hopit. Tekstet e këngëve të tyre këndohen gjithnjë në dialektin e zonave të sipërme të Austrisë.

Mënyra se si Falkner i bie fizarmonikës është mjeshtërisht ndryshe duke i dhënë nuancat e një kitare elektrike.





## VIENNA SALUTES TIRANA

Koncerti madhështor i çeljes së vitit kulturor Austri-Shqiperi 2018, me pjesëmarrjen e artistëve dhe muzikantëve të njohur shqiptarë dhe austriakë, si soprano Inva Mula, pianisti dhe kompozitori Genc Tukiçi, mexosoprano Vikena Kamenica, balerinët solistë të Teatrit të Operas, Enada dhe Gert Vaso, si dhe mjeshtri koncertal Benjamin Ziervogel me kuartetin e tij të mrekullueshëm ACIES, bas baritoni i Operës Shtetërore të Vjenës Thomas Tatzl, dhe me pjesëmarrjen ekskluzive të një prej tenorëve më të duartrokatur të shekullit 21, Ramon Vargas. Koncert i mbajtur në Pallatin e Kongreseve, 2018.



20 Shtator



## POETI 15 VJECAR

Filmi i kushtohet poetit 15 vjeçar, Ervin Hatibi. Dokumentari jep pamje nga 15 vjetori i tij, duke festuar, të rinj duke kërcyer. Shfaqen pamje nga dhoma e punës, nga udhëtimi i tij për në fshatin Ibe, nga biseda me poetin dhe me shokët e tij. Gjatë gjithë dokumentarit planet ndërthuren me poezitë e tij.

Regjia: Halil Kamberi, Skenari: Halil Kamberi, Fatmir Alimani Muzika: Mira Mecule, Producent: Shqipëria e Re, Viti: 1990, Kohëzgjatja: 21'





GEMEINSAMES  
NEUENTDECKEN  
TË RIZBULOJMË  
TË PËRBASHKËTAT  
AUSTRIA - ALBANIA CULTURAL YEAR 2018

**MUSIC-FILM  
TIRANA FESTIVAL**

## PROGRAMI I FESTIVALIT

Çdo ditë duke filluar nga ora 19-30

<i>Live Concert: LOUIE AUSTEN</i> (Këgetar dhe jazz pianist Austriak)	13.09.2018
<b>TINGUJ TË ZJARRTË</b>   Ardian Murraj   1991   27'	13.09.2018
<b>SUMMER NIGHT'S Concert in Schönbrunn</b> , Wiener Philharmoniker	13.09.2018
<b>AIDA</b> in Salzburg Festival	14.09.2018
<b>PRANVERE NE GIROKASTER</b>   Muharrem Fejzo   1978   86'	14.09.2018
<i>Live Concert: HOT CLUB TIRANA</i> - Jazz Band	15.09.2018
<b>Kolazh me këngët e festivaleve për fëmije në vite</b>	15.09.2018
<b>ANNA BOLENA</b> , in Wiener Staatsoper, with E. Garanca & A. Netrebko	15.09.2018
<b>Në festivalin e 11-të të Këngës</b>   Donika Muci   1973   11'	15.09.2018
<b>PAROV STELAR</b> Concert in Baloise Session	16.09.2018
<b>VALLËZIMI I SHQIPEVE</b>   Endri Keko   1960   20'	16.09.2018
<b>Wolfgang Amadeus Mozart</b> : Requiem in D minor, KV 626	17.09.2018
<b>HONEYMOONS</b>   Goran Paskaljevic, Genc Permeti   2009   95'	17.09.2018
<b>FALCO – Helden von heute</b>	18.09.2018
<b>Këngë e valle nga gurra popullore</b>   Gëzim Erebara   1969   69'	18.09.2018
<b>SILK ROAD</b> - Viennas Boys Choir - Songs along the Road and the Time	19.09.2018
<b>KARNAVALET</b>   Ismail Zhabjaku   1980   81'	19.09.2018
<b>Live Koncert : ATTWENGER</b>	20.09.2018
<b>Vienna Salutes Tirana</b> - Koncert 2018	20.09.2018
<b>POETI 15 VJEÇAR</b>   Halil Kamberi   1990   20'	20.09.2018



GEMEINSAMES  
NEUENTDECKEN

TË RIZBULOJMË  
TË PËRBASHKËTAT

AUSTRIA - ALBANIA CULTURAL YEAR 2018


# MUSIC-FILM TIRANA FESTIVAL

13-20 SHTATOR  
në Pazarin e Ri

*Ky festival u mundësua nga:*



AUSTRIAN  
EMBASSY  
TIRANA



SIGMA INTERALBANIAN  
VIENNA INSURANCE GROUP



Raiffeisen  
INVEST



LOTARIA KOMBËTARE



vodafone



BASHKIA  
TIRANË

A  
Q  
SH  
F



ARRIVI  
QENDRORE  
SHITËTOR  
I FILMIT



QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË



pazariri

